



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 4635 Prot

Lezhë, më 26 / 4 /2023

VENDIM

Nr. 33, Datë 25. 04. 2023

Për përdorimin e fondit të emergjencës për mbulimin e shpenzimeve të strehimit (qirasë së banesave) për 4 familje në fshatin Sukaxhi, Njësia Administrative Ungrej pasi kanë dalë të pastreha si shkak i dëmtimit të banesave nga rrëshqitja e dherave.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të ligjit nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, të VKM nr.414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar për Mbrojtjen Civile”; ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social” dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

VENDOSI:

1.Miratimin e përdorimit të fondit të emergjencës në shumën 223,200 lekë për mbulimin e shpenzimeve të strehimit (qirasë së banesave) për 4 familje në fshatin Sukaxhi, Njësia Administrative Ungrej, pasi banesat e tyre janë bërë të pabanueshme si shkak i rrëshqitjes së dherave.

Për këtë të kryhen veprimet në programin buxhetor Gr.00, Prog.03280, Kap.05, Art./llog.ek.606 për shumën 223,200 lekë.

2.Mbulimi i qirasë së banesave do të jetë për periudhën 01.01.2023 - 30.06.2023.

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**

**KRYETARI
NDUE LULI**



Prot. 4635/

DT 2.4.23

ICB



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË MBROJTJES CIVILE DHE KRIZAVE

Nr. 357/16 Prot.

Lezhë, më 28.04.2023

Lënda. Konfirmim vendimi.

KËSHILLIT TË BASHKISË

KRYETARIT TË BASHKISË

Lezhë

Bazuar në ligjin nr.107/2016, "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pika 2/b; në ligjin nr.139, datë 17.12.2015, "Për vetëqëverisjes vendore", neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, 1.1, germa 'b', neni 54, germa 'n'; neni 55; në ligjin nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", neni 41; si dhe në VKM nr.329, datë 16.05.2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"; konfirmoj bazueshmërin ligjore të **Vendimit nr.33, datë 25.04.2023**, "Për përdorimin e fondit të emergjencës për mbulimin e shpenzimeve të strehimit, (qirasë së banesave), për 4 familje në fshatin Sukaxhi, Njësia Administrative Ungrej, pasi kanë dalë të pastreha si shkak i dëmtimit të banesave nga rrëshqitja e dherave", bashkia Lezhë.

PREFEKTI
Gjergj PRENDI

